

Vendim nr. 20 datë 05.04.2023

(V-6/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datën 16.03.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 6 (D) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **DASHMIRA ZARO**, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar me autorizim nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar me autorizim nga Qemal Zaimi.

OBJEKTI: **Konstatimi i vijimit të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjyqimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit 6-mujor të përcaktuar në vendimin nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.**
Konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për dëmshpërblim pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 322, datë 15.04.2015 “*Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, Ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit*” (VKM nr. 322/2015), ka vendosur shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i këtij projekti.

2. Mbi bazën e kësaj VKM-je, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Gjirokastrë ka kufizuar pronën e kërkueses, të ndodhur në zonën e emërtuar Viroi – Gjirokastrë, të cilën ajo e kishte fituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si trashëgimtare ligjore e ish-pronarit. Me pretendimin se i janë cenuar interesat e ligjshëm për pronën e mbetur pas shpronësimit, kërkuësja ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, duke kërkuar konstatimin e vendosjes së kufizimit mbi tagrat e pronësisë që barazohet me shpronësimin e pjesës së mbetur të pronës pas shpronësimit me VKM-në nr. 322/2015, detyrimin e ZVRPP-së, Gjirokastrë, të hedhë gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, detyrimin e Bashkisë Gjirokastrë të ndalojë cenimin e pronës dhe të heqë barrierën e palëvizshme metalike nga rruga, si dhe detyrimin e kësaj bashkie dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban për nxjerrjen e akteve administrative që zgjidhin pasojat e përdorimit të pronës në funksion të rikonstruksionit të Parkut të Viroit.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 443, datë 18.07.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke urdhëruar të paditurën, ZVRPP-në, Gjirokastrë, të hedhë gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe të pajisë kërkuesen me certifikatë pronësie për pronën e mbetur nga shpronësimi me VKM-në nr. 322/2015. Në lidhje

me kërkimet për konstatimin e vendosjes së kufizimit mbi tagrat e pronësisë që barazohet me shpronësimin dhe për ndalimin e cenimit të pronësisë, si dhe nxjerrjen e akteve administrative, gjykata ka vendosur rrëzimin e tyre, kurse në lidhje me kërkimin për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe heqjen e barrierës së palëvizshme nga e paditura, Bashkia Gjirokastrë, gjykata ka shpallur moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë si gjykata kompetente.

4. Kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e mësipërm në lidhje me dy disponime të tij, konkretisht për shpalljen e moskompetencës lëndore, si dhe për pjesën që ka rrëzuar kërkimin e padisë për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 392, datë 24.07.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit për pjesën që ka shpallur moskompetencën lëndore, i cili, pasi janë ezauruar mjetet e ankimit, është lënë përfundimisht në fuqi.

5. Për sa i takon ankimit për pjesën që ka rrëzuar kërkimin e padisë për ndalimin e cenimit të pronësisë dhe nxjerrjen e akteve administrative, ai është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 19.09.2017.

6. Duke qenë se çështja e saj nuk ishte marrë ende në shqyrtim, me kërkesën e datës 20.07.2018, kërkuesja i është drejtuar relatores së çështjes dhe kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar përshpejtimin e gjykimit. Në kushtet kur nuk ka marrë përgjigje për këtë kërkesë, në datën 20.08.2018, kërkuesja, bazuar në nenet 399/1, 399/2, pikat 1, shkronja “a” dhe 2, si dhe 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, duke kërkuar edhe urdhërimin e marrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2/5/2, datë 17.06.2021, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, pasi nuk ka konstatuar zvarritje të qëllimshme të çështjes nga gjyqtari relator. Ndër të tjera, ai kolegji ka arsyetuar se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes ishte rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që e tejkalon rastin konkret dhe se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh, duke krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore, por që këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme të krijuar nga procesi i reformës (*shih paragrafët 16 dhe 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

8. Pasi është njohur me këtë vendim kërkesja e ka kundërshtuar atë në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.

9. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata, me vendimin nr. 2, datë 17.02.2022 (vendimi nr. 2/2022), ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Shfuqizimin e vendimit nr. 2/5/2, datë 17.06.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës të Lartë. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.”*. Ky vendim i është dërguar zyrtarisht Gjykatës Administrative të Apelit në datën 15.03.2022 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 23.03.2022.

10. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi kërkesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4844, datë 28.09.2022, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të paguajnë në favor të kërkueses shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë, si shpërblim për dëmin jopasuror të pësuar për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes së saj gjyqësore.

11. Duke qenë se çështja e saj në gjykatën e apelit nuk ishte shqyrtuar ende, në datën 26.09.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit në shqyrtim, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me nenin 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 14.10.2022. Kolegji i Gjykatës në datën 24.11.2022 ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje në seancë plenare publike dhe thirrjen në gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara, të Këshillit të Ministrave dhe KLGJ-së.

12. Ditën e zhvillimit të seancës plenare në këtë Gjykatë, me vendimin nr. 86-2023-328, datë 16.03.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkueses, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 443, datë 18.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

13.1. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar vendimin nr. 2/2022 të Gjykatës, me anë të të cilit i ka lindur e drejta të kërkojë dëmshpërblim sipas nenit 399/6, pika 3, të KPC-së. Gjithashtu, në kushtet kur nuk është realizuar gjykimi i çështjes brenda afatit 6-mujor të vendosur me vendimin nr. 2/2022, kërkuesja nuk ka mjete të tjera efektive për të kërkuar dëmshpërblimin për shkak të moszbatimit të këtij vendimi dhe për këtë qëllim ajo ka depozituar kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

14.1. Ai nuk është përfshirë asnjëherë si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kërkueses dhe sipas Kushtetutës nuk mund të ndërhyjë në çështje që kanë të bëjnë me kompetencat e organeve gjyqësore, për rrjedhojë nuk është përgjegjës për zbatimin e detyrave funksionale të këtyre të fundit. Referuar dispozitivit të vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës, institucioni përgjegjës për zbatimin e tij është Gjykata Administrative e Apelit.

14.2. Pretendimi i kërkueses se Gjykata me vendimin nr. 2/2022 e ka legjitimuar atë të kërkojë dëmshpërblim, është haptazi i pabazuar. Për sa i përket kërkesës për shpërblimin e dëmit, ajo duhet t'i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor, pasi kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

15. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1. KLGJ-ja nuk është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kërkueses dhe për këtë arsye nuk ka interes. Sipas vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës, institucioni përgjegjës për zbatimin e tij është Gjykata Administrative e Apelit dhe KLGJ-ja nuk ka tagër të ndërhyjë në veprimtarinë e gjykatave ose në vendimmarrjen e tyre.

15.2. Në lidhje me thelbin e kërkesës, cenimi i së drejtës së kërkueses për zhvillimin e procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm është konstatuar me vendimin nr. 2/2022 të Gjykatës. Në këtë kuptim, Gjykata i ka dhënë një herë përgjigje këtij pretendimi të kërkueses, ndaj ky gjykim kushtetues mbetet pa objekt.

15.3. I pabazuar është edhe kërkimi për konstatimin e mungesës së mjetit ligjor efektiv për dhënien e dëmshtëpërblimit pas dhënies së vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës, pasi është pikërisht ky i fundit që i ka dhënë të drejtë kërkueses të kërkojë shpërblimin e dëmit sipas nenit 399/6 të KPC-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

16. Çështja e legjitimitetit të subjekteve (*locus standi*) që mund t'i drejtohen Gjykatës është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar asaj me kërkesën në shqyrtim, duke pretenduar vijimin e konstatimit të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjyimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit (*kërkimi i parë*), si dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për dëmshtëpërblimin, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit nr. 2/2022 të kësaj Gjykate (*kërkimi i dytë*).

18. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i këtyre vendimeve është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 17, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsytimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale. Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është

theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se kërkesja, për të njëjtat shkaqe mbi të cilat ka mbështetur kërkimin e parë në këtë ankim kushtetues individual, i është drejtuar edhe më parë asaj me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 2/2022, Gjykata ka vendosur pranimin e saj, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke përcaktuar një afat prej 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për gjykimin e çështjes gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit. Për rrjedhojë, pasi ka marrë në shqyrtim në themel kërkesën dhe shkaqet mbi të cilat bazohej ajo, Gjykata u ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkueses, duke përcaktuar edhe detyrimin që rrjedh për autoritetet publike, në këtë rast gjykatat, për respektimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

20. Megjithatë, Gjykata konstaton se deri në datën e paraqitjes së kërkesës në shqyrtim Gjykata Administrative e Apelit nuk e kishte shqyrtuar ende çështjen e kërkueses edhe pse kishte kaluar afati 6-mujor i përcaktuar prej saj. Ndërkohë që në të njëjtën ditë me atë të caktuar për zhvillimin e seancës plenare, Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendim për ankimin e kërkueses, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 443, datë 18.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kësaj çështjeje është bërë pas rreth 1 viti nga hyrja në fuqi e vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës. Pavarësisht këtij fakti, prapëse vonesës së shqyrtimit të çështjes me rreth 6 muaj, Gjykata vëren se mjeti procedural i përdorur nga kërkesja, ashtu si edhe ankimi kushtetues individual, e ka arritur qëllimin e tij përshpejtues, për sa kohë që Gjykata Administrative e Apelit e ka përshpejtuar gjykimin e çështjes së kërkueses, të regjistruar pranë saj duke u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë substanciale që lidhen me cenimin e interesave të ligjshëm në pronën e mbetur pas shpronësimit.

21. Po kështu, Gjykata konstaton se në bazë të vendimit të saj nr. 2/2022, kërkueses i ka lindur edhe e drejta për shpërblimin e drejtë, për shkak të vonesës në shqyrtimin e çështjes. Edhe pse me vendimin nr. 4844, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur shpërblimi i kërkueses për periudhën nga 19.03.2019, deri më 23.03.2022, kur ka hyrë në fuqi vendimi nr. 2/2022 i Gjykatës, ajo nuk ka asnjë pengesë të kërkojë shpërblimin e drejtë për shkak

të vonesës së shqyrtimit të çështjes me rreth 6 muaj nga Gjykata Administrative e Apelit. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se mjetet e reja procedurale të parashikuara nga KPC-ja synojnë të garantojnë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm jo vetëm në drejtim të përsheptimit të procedurave, si mjete me natyrë parandaluese, por edhe në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur, në rast se është konstatuar me vendim gjyqësor shkelja e afatit të arsyeshëm të gjykimit, përmes jo vetëm urdhërimit të përfundimit të procedurave në një kohë sa më të shpejtë, por edhe caktimit të një shpërblimi të drejtë.

22. Për sa më lart, Gjykata në parim vlerëson të theksojë se pretendimet e individit për moszbatimin e vendimeve të saj mund të përbëjnë një çështje të re në raport me atë tashmë të marrë në shqyrtim prej saj, nëse veprimet ose mosveprimet e organeve të ngarkuara për zbatimin e vendimeve të Gjykatës krijojnë mosmarrëveshje kushtetuese. Kjo do të thotë se Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë thjesht masën ose mënyrën se si po zbatohet një vendim i saj dhe se ankimi kushtetues individual nuk mund të përdoret si mjet për kontrollin e kushtetutshmërisë së ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore jashtë kufijve të kompetencave të kësaj Gjykate.

23. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim pretendimi për konstatimin e vijimit të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të moszbatimit të vendimit të Gjykatës, nuk përbën një shkak të ri ose një mosmarrëveshje të re kushtetuese për shqyrtimin e këtij pretendimi. Prandaj, në lidhje me pretendimin e parë të objektit të kësaj kërke, Gjykata vlerëson se vetëm fakti i mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit 6-mujor nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të argumentuar pretendimin e cenimit të të drejtave kushtetuese, për sa kohë që vendimi nr. 2/2022 ka dhënë pasojat e tij në drejtim të caktimit të shpërblimit të drejtë të kërkuës.

24. Gjithashtu, Gjykata vëren se sistemi kushtetues ofron një strukturë të plotë institucionale për t'u garantuar individëve të drejtën e një procesi të rregullt ligjor në të gjitha aspektet e tij, përfshirë atë të gjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Kjo do të thotë se krahas mbrojtjes kushtetuese të kësaj të drejte, e cila bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ka natyrë përfundimtare, veprojnë edhe institucione të tjera sipas kompetencave dhe përgjegjësi të tyre, ku përfshihen gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla, KLGJ-ja për të siguruar përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë për verifikimin e ankesave administrative dhe inspektimin institucional të gjykatave.

25. Në lidhje me kërkimin e dytë të kërkuases, që ka të bëjë me mungesën e mjeteve efektive për të kërkuar dëmshpërblimin, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike efektive përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Gjykata ka evidentuar se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 05.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t’i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate në parim janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Gjykata vëren se kërkesja nuk ka përdorur ndonjë nga mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për të kërkuar shpërblimin e dëmit për shkak të vijimit të shkeljes nga Gjykata Administrative e Apelit, që është mosshqyrtimi i çështjes brenda afatit të përcaktuar nga vendimi nr. 2/2022. Për rrjedhojë, kërkesja nuk ka arritur të argumentojë mungesën e efektivitetit të këtij mjeti, për më tepër kur kërkesa e parë e saj për shpërblimin e dëmit jopasuror për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes gjyqësore, e shqyrtuar me vendimin

nr. 4844, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rezultuar të jetë një mjet efektiv për kërkuesen (*shih paragrafin 10 të këtij vendimi*). Për këtë arsye, as ky pretendim i kërkueses nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkimet e parashtruara në këtë ankim kushtetues individual janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 05.04.2023

Shpallur më 04.05.2023

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 6 (D) 2022 të Regjistrisë Themeltar, me kërkuese Dashmira Zaro dhe objekt: *“Konstatimi i vijimit të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt si pasojë e mosgjyqimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit 6-mujor të përcaktuar në vendimin nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese. Konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për dëmshpërblim pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.”*, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës në lidhje me kërkimin e parë, për rrjedhojë, në vijim, do të parashtroj argumentet që mbështesin qëndrimin tim si gjyqtare në pakicë.

2. Duke iu referuar objektit të kësaj kërkesë, shumica i ka konsideruar kërkimet në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra, duke i vlerësuar ato po veçmas dhe duke i vlerësuar në lidhje me kërkimin e parë se *“vetëm fakti i mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit 6-mujor nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të argumentuar pretendimin e të drejtave kushtetuese, për sa kohë që vendimi nr. 2/2022 ka dhënë pasojat e tij në drejtim të caktimit të shpërblimit të drejtë të kërkuësës.”* (shih paragrafin 23 të vendimit). Kurse në lidhje me kërkimin e dytë shumica ka vlerësuar se *“kërkuësja nuk ka përdorur ndonjë nga mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për të kërkuar shpërblimin e dëmit për shkak të vijimit të shkeljes nga Gjykata Administrative e Apelit, që është mosshqyrtimi i çështjes brenda afatit të përcaktuar nga vendimi nr. 2/2022. Për rrjedhojë, kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë mungesën e efektivitetit të këtij mjeti, për më tepër kur kërkesa e parë e saj për shpërblimin e dëmit jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes gjyqësore, e shqyrtuar me vendimin nr. 4844, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rezultuar të jetë një mjet efektiv për kërkuësen.”* (shih paragrafin 27 të vendimit).

3. Kërkuësja, në objektin e ankimit kushtetues individual, ka kërkuar vijimin e konstatimit të cenimit të procesit të rregullt ligjor, me pretendimin se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar vendimin nr. 2/2022 të Gjykatës dhe lidhur me këtë kërkim edhe konstatimin e mungesës së mjeteve juridike efektive për të kërkuar dëmshpërblimin, për shkak të moszbatimit të vendimit nr. 2/2022. Për rrjedhojë, këto kërtime janë të ndërvarura me njëra-tjetrën dhe në vlerësimin tim nuk duhet të shihen si kërtime të ndryshme, pasi konstatimi i vijimit të cenimit të së drejtës për t`u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është i lidhur me pasojën e tij, pra të drejtën

për shpërblim të drejtë, në kuptim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Vetëm konstatimi i cenimit të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të tij, passjell për kërkuesen të drejtën për të kërkuar një shpërblim të drejtë si një mjet me natyrë riparuese.

4. Edhe pse kërkuesja ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar vendimin nr. 2/2022 të Gjykatës, duke mos e gjykuar çështjen brenda afatit 6-mujor të përcaktuar në këtë vendim, në thelb, objekt i këtij gjykimi është cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e kohëzgjatjes së procedurave. Sipas shumicës, *“kërkuesja, për të njëjtat shkaqe mbi të cilat ka mbështetur kërkimin e parë në këtë ankim kushtetues individual, i është drejtuar edhe më parë Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 2/2022, Gjykata ka vendosur pranimin e saj, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke përcaktuar një afat prej 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për gjykimin e çështjes gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit. Për rrjedhojë, pasi ka marrë në shqyrtim në themel kërkesën dhe shkaqet mbi të cilat bazohet ajo, Gjykata u ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkueses, duke përcaktuar edhe detyrimin që rrjedh për autoritetet publike, në këtë rast gjykatat, për respektimin e standardit të gjykitimit brenda një afati të arsyeshëm.”* (shih paragrafin 19 të vendimit).

5. Nga ky arsyetim i shumicës duket sikur jemi përpara “gjësë së gjykuar” edhe pse kjo nuk është shprehur në mënyrë eksplicite, ndërkohë që, në rastin konkret, vlerësoj se jemi përpara cenimit vijues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që në këtë rast, në thelb, lidhet me shkaqe të tjera nga ato të shqyrtuara në vendimin e parë, që është moszbatimi i vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës. Për këtë arsye, Gjykata, në kuptim të kompetencës së saj, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, në vlerësim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhej të ndalej në vlerësimin nëse organet shtetërore (në rastin konkret Gjykata Administrative e Apelit) kanë vepruar në përputhje me përcaktimet e vendimmarrjes së saj.

6. Edhe në praktikën e saj përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2016, kur të tilla kërkesa për konstatimin e cenimit shqyrtoheshin drejtpërdrejt nga Gjykata për mungesë të mjeteve të tjera juridike efektive, ajo, në shumë raste, edhe pse e kishte konstatuar më parë shkeljen e afatit të arsyeshëm, ka marrë në shqyrtim të njëjtën çështje kur shkelja kishte karakter vijues dhe organet shtetërore nuk kishin marrë masat përkatëse. Në situatën aktuale, duke pasur parasysh edhe se

konstatimi i cenimit i jep të drejtë subjektit të cenuar për të kërkuar shpërblimin e dëmit, vendimmarrja e kësaj Gjykate, në rastet e vijimit të cenimit merr rëndësi, pasi nuk e lë këtë vlerësim në çmimin e gjykatës së zakonshme, siç pretendon shumica.

7. Duke u ndalur shkurtimisht në thelbin e pretendimit, nga aktet rezulton se në datën 12.10.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me anë të *e-mail-it*, duke i kërkuar informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhej çështja e saj. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Gjykata Administrative e Apelit e ka vënë në dijeni se çështja e kërkuësës nuk ka ende një datë të planifikuar për gjykim. Në përgjigje të shkresës së dërguar nga Gjykata, për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata Administrative e Apelit e ka informuar se seanca gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së kërkuësës ishte planifikuar të zhvillohej në datën 16.03.2023.

8. Bazuar në këto fakte, konstatohet se edhe pse kishte kaluar rreth një vit, Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka respektuar detyrimin për shqyrtimin e çështjes së kërkuësës brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës, ndërkohë që sjellja e saj lë vend për dyshime se ajo është vënë në lëvizje dhe ka caktuar datën e seancës gjyqësore për kërkuësen, pasi i është kërkuar informacion për këtë çështje, çka nënkupton se nuk ka pasur ndonjë pengesë për shqyrtimin e saj edhe më parë, në zbatim të detyrimit që kishte lindur nga një vendim i kësaj Gjykate, që në kuptim të nenit 132 të Kushtetutës është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim.

9. Për sa më lart, vlerësoj se Gjykata Administrative e Apelit, duke mos respektuar forcën detyruese të vendimit nr. 2/2022 të Gjykatës, nuk ka përmbushur funksionin e saj kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar para saj, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së kërkuësës për një proces të rregullt ligjor.

10. Për të gjitha argumentet e parashtruara më sipër, vlerësoj se kërkesa është e bazuar, ndaj duhej të ishte vendosur pranimi i saj dhe konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor ku kërkesja është palë, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Anëtare: Sonila Bejtja